



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.129

3 tetor

2007

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9805 datë 17.9.2007	Për ratifikimin e “Memorandumit të mirëkuptimit për lehtësimin e transportit civil jetësor ndërkufitar” 3619
Ligj nr.9806 datë 17.9.2007	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane “Për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike” (të rishikuar) 3622

LIGJ
Nr.9805, datë 17.9.2007

**PËR RATIFIKIMIN E “MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR LEHTËSIMIN E
TRANSPORTIT CIVIL JETËSOR NDËRKUFITAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Memorandumi i mirëkuptimit për lehtësimin e transportit civil jetësor ndërkufitar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5465, datë 28.9.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
PËR LEHTËSIMIN E TRANSPORTIT CIVIL JETËSOR NDËRKUFITAR

Shtetet Palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shtetet, të cilat kanë pranuar ftesën e Partneritetit për Paqe (PfP), të lëshuar e të nënshkruar nga krerët e shteteve dhe krerët e qeverive të shteteve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior në Bruksel, më 10 janar 1994 dhe që kanë nënshkruar Dokumentin Kuadër të Partneritetit për Paqe, të referuar më poshtë individualisht si Pjesëmarrësi dhe bashkërisht si Pjesëmarrësit:

të bindur për ngritjen e Këshillit Euroatlantik të Partneritetit, që siguron kuadrin gjithëpërfshirës për këshillime ndërmjet anëtarëve të tij;

duke pasur parasysh se personeli civil i ndihmës, si edhe materiale të ndryshme të njërit prej Pjesëmarrësve në këtë Memorandum Mirëkuptimi (MoU), sipas marrëveshjes, mund të dërgohen, të merren apo të kalojnë transit në territorin e një Pjesëmarrësi tjetër, në rastet e lidhura me bashkëpunimin civil, veçanërisht në fushën e përbaljes me pasojat e përdorimit dhe/apo të aksidenteve të agjentëve kimikë, biologjikë, radiologjikë dhe bërthamorë (CBRN), duke përfshirë këtu aktet e terrorizmit, ndihmën humanitare dhe ndihmën në raste fatkeqësish;

duke mbajtur në mendje se vendimi dhe kushtet, sipas të cilave personeli civil i ndihmës që do të kryejë këtë bashkëpunim civil, si edhe materialet, do të dërgohen, merren apo kalojnë transit, duke qenë se nuk janë të përcaktuara në këtë Memorandum, ato do të vazhdojnë t’i nënshtrohen marrëveshjeve të veçanta ndërmjet Pjesëmarrësve të interesuar;

duke mbajtur parasysh se anëtarët e Forcave të Armatosura dhe përbërësit e tyre civilë mbulohen nga kushtet e Marrëveshjes ndërmjet Palëve në Traktatin e Atlantikut Verior në lidhje me statusin e forcave të tyre, të bërë në Londër, më 19 qershor 1951 dhe Marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut Verior dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe në lidhje me statusin e forcave të tyre të bërë në Bruksel, më 19 qershor 1995, si dhe protokollat bashkëlidhur;

duke vënë re për më tepër, dobinë e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe marrëveshjeve mbi bashkëpunimin civil në kuadrin e Partneritetit për Paqe;

duke dëshiruar që të lehtësojnë transportin civil jetësor,
kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm:

PARAGRAFI 1 PËRKUFIZIME

Në këtë Memorandum shprehja:

1. “Fatkeqësi” nënkupton një ngjarje të natyrës CBRN (shih më lart), qoftë kjo aksidentale apo e tjetër natyre, si edhe fatkeqësi të tjera natyrore apo teknike, të cilat sjellin si rrjedhojë nevojën për ndihmë;
2. “Personel i ndihmës” nënkupton ndër të tjera, individët civilë, grupet e individëve civilë, skuadrat, si edhe njësitë e krijuara të njërit Pjesëmarrës që janë nën autoritetin e tij dhe që dërgohen për në apo përmes territorit të një Pjesëmarrësi tjetër për t’u përballur me pasojat e një fatkeqësie dhe që njihet si i tillë nga Pjesëmarrësit e interesuar;
3. “Materiale” nënkupton çfarëdo pajisje, mjet transporti dhe mallra, që do të përdoren në lidhje me bashkëpunimin civil në kuadrin e përballjes me pasojat e një fatkeqësie, përfshirë këtu pajisje, automjete dhe artikuj të tjerë që nevojiten për përdorimin vetjak të personelit të ndihmës;
4. “Transport civil jetësor” nënkupton transportin, përfshirë atë transit, e personelit të ndihmës dhe të materialeve nga Pjesëmarrësi dërgues për te Pjesëmarrësi kërkues nga uji, toka ose ajri, të cilët janë të nevojshëm për të plotësuar kërkesat jetësore të popullatës së prekur, me qëllim që kjo e fundit të përballlet me pasojat e një fatkeqësie;
5. “Pjesëmarrësi kërkues” nënkupton Pjesëmarrësin, autoritetet kompetente të të cilit kërkojnë dhe lejojnë të mbështeten nga një Pjesëmarrës tjetër në fushat e përballjes me pasojat e një fatkeqësie;
6. “Pjesëmarrësi dërgues” nënkupton Pjesëmarrësin, i cili siguron personelin e ndihmës dhe mbështetje të tjera të kërkuara dhe të lejuara nga Pjesëmarrësi kërkues për përballjen me pasojat e një fatkeqësie;
7. “Transit” nënkupton çfarëdo kalimi në territorin e një Pjesëmarrësi, duke përfshirë këtu hapësirën e tij ajrore dhe ujërat territoriale nga ana e personelit të ndihmës dhe nga materialet e Pjesëmarrësit dërgues, përfshirë këtu edhe ndihmën e nevojshme në fushën e mbështetjes për njësitë që po transportohen, si p.sh. mbështetja për personelin, ajo shëndetësore, rifurnizimi, mbështetja teknike dhe logjistike, me qëllim përballjen me pasojat e një fatkeqësie.

PARAGRAFI 2 ZBATIMI

1. Pjesëmarrësit do të lehtësojnë transportin civil jetësor në përputhje me arritjet e këtij Memorandumi.
2. Sipas gjykimit të përbashkët, ky Memorandum nuk përbën një marrëveshje ligjërish të detyrueshme. Si rrjedhim, ai nuk cilësohet si i mundshëm për regjistrim, sipas nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

PARAGRAFI 3 NJOFTIMI DHE BASHKËRENDIMI

1. Çdo Pjesëmarrës do të përcaktojë një apo disa pika kombëtare kontakti për të lehtësuar dhe bashkërenduar transportin civil jetësor dhe për t’ua njoftuar këtë Pjesëmarrësve të tjerë; p.sh. për transportin e mallrave të rrezikshme, lejet teknike, grupet e shoqërimit, lejet diplomatike dhe procedurat doganore.
2. Një Pjesëmarrës, përmes të cilit do të kalojnë personeli i ndihmës dhe materialet, do të njoftohet pa vonesë nga Pjesëmarrësi dërgues mbi mënyrat e parashikuara të transportit, pikat e kalimit kufitar ku propozohet të bëhet kalimi, rrugët që do të ndiqen dhe informacione të tjera të nevojshme.
3. Mënyrat e përshtatshme të transportit, pikat e kalimit kufitar dhe rrugët që do të ndiqen, do të vendosen me këshillim ndërmjet Pjesëmarrësve të interesuar, duke marrë parasysh kërkesat dhe burimet e njohura në dispozicion dhe kërkesat e brendshme.
4. Nëse transporti civil jetësor do të bëhet tërësisht apo pjesërisht i pamundur duke përdorur mënyrat e zgjedhura të transportit, hollësitë e mënyrave alternative do të vendosen nga Pjesëmarrësit.

PARAGRAFI 4 LOGJISTIKA, MËNYRAT ALTERNATIVE TË TRANSPORTIT DHE PËRPARËSIA

1. Një Pjesëmarrës kërkues do t'i sigurojë transportit civil jetësor të Pjesëmarrësve të tjerë të gjithë logjistikën e nevojshme dhe lehtësitë administrative.

2. Pjesëmarrësit do t'i japin të njëjtën përparësi transportit civil jetësor, si edhe transportit civil të brendshëm në raste fatkeqësish.

3. Pjesëmarrësit do të sigurojnë kthimin e personelit të ndihmës dhe materialeve.

4. Edhe nëse kufijtë shtetërorë të një Pjesëmarrësi janë të mbyllur, qoftë plotësisht apo pjesërisht, Pjesëmarrësit, përsa të jetë e mundur, do të lejojnë transitin për personelin e ndihmës dhe për materialet.

PARAGRAFI 5

KALIMI I KUFIRIT, QËNDRIMI DHE DOGANAT

1. Në përputhje me rregullat formale për hyrjen dhe daljen nga territori i një Pjesëmarrësi, personeli i ndihmës, kurdoherë që të jetë e mundur, do të përjashtohet nga rregullat për vizat dhe nga inspektimi i autoriteteve të migrimit. Në rastin kur këto rregulla për vizat dhe inspektimet nga autoritetet e migrimit nuk mund të shmangen, një Pjesëmarrës do të përshpejtojë formalitetet e nevojshme në pikën e duhur të hyrjes. Personeli i ndihmës do të përjashtohet, kurdoherë që të jetë e mundur, nga rregulloret e një Pjesëmarrësi mbi regjistrimin dhe kontrollin e të huajve dhe nuk do të konsiderohet sikur po përfiton ndonjë të drejtë qëndrimi apo banimi të përhershëm në territorin e një Pjesëmarrësi.

2. Pjesëmarrësit do të lejojnë, përsa të jetë e mundur nga legjislacioni i zbatueshëm në këtë rast, hyrjen, transitimin apo daljen, si edhe të sigurojnë, kur është e zbatueshme, lehtësimin nga të gjitha detyrimet doganore, taksat dhe shpenzime të tjera të lidhura me to, përveç pagesave për shërbime të kërkuara dhe të marra.

PARAGRAFI 6

RREGULLIME TË TJERA

Pjesëmarrësit, nëse është e nevojshme, mund të përfundojnë marrëveshje shtesë, teknike apo administrative, me qëllim që të përcaktojnë hollësitë praktike të zbatimit të këtij Memorandumi.

PARAGRAFI 7

PARIMI I TERRITORIALITETIT

Personeli i ndihmës do të respektojë ligjet e Pjesëmarrësit apo Pjesëmarrësve kërkues, që sigurojnë transitimin dhe nuk do të përfshihet në asnjë veprimtari që nuk është në përputhje me këtë Memorandum. Pjesëmarrësi dërgues do të marrë masat e nevojshme për këtë qëllim.

PARAGRAFI 8

MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin apo zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhen nëpërmjet rrugëve diplomatike.

PARAGRAFI 9

TËRHEQJA

Cilido Pjesëmarrës mund të tërhiqet nga ky Memorandum, duke dorëzuar një njoftim me shkrim në lidhje me këtë te Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, i cili do të informojë të gjithë Pjesëmarrësit e tjerë mbi këtë njoftim. Tërheqja do të hyjë në fuqi tre muaj pas marrjes së njoftimit nga Pjesëmarrësit e tjerë. Me mbarimin e kësaj periudhe, ky Memorandum nuk do të ketë më fuqi në lidhje me Pjesëmarrësit që janë tërhequr nga ai, përveçse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që kanë lindur përpara ditës në të cilën tërheqja ka hyrë në fuqi, por Memorandumi do të vazhdojë të mbetet në fuqi për Pjesëmarrësit e tjerë që mbeten.

PARAGRAFI 10

NËNSHKRIMI DHE HYRJJA NË FUQI

1. Ky Memorandum do të jetë i hapur për nënshkrim nga cilido shtet që është palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut ose ka pranuar ftesën për Partneritetin për Paqe dhe ka nënshkruar dokumentin kuadër

të Partneritetit për Paqe.

2. Ky Memorandum do të hyjë në fuqi për secilin shtet nënshkrues në datën e nënshkrimit.

Sa më sipër, përfaqëson mirëkuptimin e vendosur ndërmjet Pjesëmarrësve mbi çështjet e përcaktuara në këtë Memorandum.

Ky Memorandum hartohet në gjuhën angleze dhe frënge, të dyja tekstet njëlloj origjinale.

LIGJ

Nr.9806, datë 17.9.2007

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN EUROPIANE “PËR MBROJTJEN E TRASHËGIMISË ARKEOLOGJIKE” (TË RISHIKUAR)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën Europiane “Për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike” (të rishikuar).

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5466, datë 28.9.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

KONVENTA EUROPIANE

PËR MBROJTJEN E TRASHËGIMISË ARKEOLOGJIKE (E RISHIKUAR)

Hyrje

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe Shtetet e tjera Palë në Konventën Kulturore Europiane, nënshkrues të kësaj:

duke ditur që qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij me synim, veçanërisht mbrojtjen dhe përmbushjen e idealeve dhe primeve, të cilat janë trashëgimia e tyre e përbashkët;

duke pasur parasysh Konventën Kulturore Europiane të nënshkruar në Paris, më 19 dhjetor 1954, veçanërisht nenet 1 dhe 5 të saj;

duke pasur parasysh Konventën për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkitekturore të Europës, nënshkruar në Granada, më 3 tetor 1958;

duke patur parasysh Konventën Europiane mbi veprat penale në lidhje me pasurinë kulturore, nënshkruar në Delfi, më 23 qershor 1985;

duke pasur parasysh rekomandimet e Asamblesë Parlamentare mbi arkeologjinë dhe në veçanti rekomandimet 848 (1978), 921 (1981) dhe 1072 (1988);

duke pasur parasysh rekomandimet nr.R (89) 5, në lidhje me mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë arkeologjike, në kuadër të operacioneve planifikuese të qytetit dhe fshatit;

duke kujtuar që trashëgimia kulturore është thelbësore për njohjen e historisë njerëzore;

duke njohur faktin që trashëgimia arkeologjike europiane, e cila është dëshmi e historisë së lashtë,

rrezikohet seriozisht nga shkatërrimet, për shkak të numrit në rritje të skemave të mëdha planizuese, rreziqeve natyrore, gjurmëve të paligjshme dhe joshkencore dhe ndërgjegjësimit publik të pamjaftueshëm;

duke pohuar që është e rëndësishme të fillohen, aty ku nuk ekzistojnë akoma, procedura mbikëqyrjeje të përshtatshme administrative dhe shkencore dhe se nevoja për të mbrojtur trashëgiminë arkeologjike duhet reflektuar në planifikimin urban dhe rural dhe në politikat e zhvillimit të kulturës;

duke theksuar se përgjegjësia për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike nuk duhet të jetë vetëm i shtetit drejtpërdrejt të interesuara, por i të gjitha vendeve europiane, ku qëllimi është zvogëlimi i rrezikut të shkatërrimeve dhe promovimi i konservimit, nëpërmjet nxitjes së shkëmbimeve të ekspertëve dhe krahasimit të përvojave;

duke njohur nevojën për realizimin e parimeve të përcaktuara në Konventën Europiane për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike, nënshkruar në Londër, më 6 maj 1969, si rezultat i evoluimit të politikave planifikuese në vendet europiane,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Përkufizimi i trashëgimisë arkeologjike

Neni 1

1. Qëllimi i kësaj Konvente (të rishikuar) është mbrojtja e trashëgimisë arkeologjike si një burim i kujtesës kolektive europiane, dhe si një mjet për studime historike dhe shkencore.

2. Për këtë qëllim, elemente të trashëgimisë arkeologjike konsiderohen të gjitha rrënojat dhe objektet dhe çdo gjurmë tjetër e njerëzimit nga epokat e kaluara:

i) ruajtja dhe studimi i të cilave ndihmon në rigjurmimin e historisë së njerëzimit dhe lidhjet e saj me mjedisin natyror;

ii) për gjurmët dhe zbulimet e të cilave dhe metodat e tjera të studimit të njerëzimit dhe mjedisit përkatës janë burimet kryesore të informacionit; dhe

iii) të cilat janë të vendosura në cilëndo zonë brenda juridiksionit të Palëve.

3. Trashëgimia arkeologjike përfshin strukturat, konstruksionet, grupet e ndërtesave, vendet e zhvilluara, objektet e lëvizshme, monumentet e llojeve të tjera, si dhe konteksti i tyre, qofshin mbi tokë ose nën ujë.

Identifikimi i trashëgimisë dhe masat për mbrojtje

Neni 2

Secila Palë merr përsipër të krijojë, me mjetet e duhura të shtetit në fjalë, një sistem ligjor për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike, duke parashikuar:

i) mbajtjen e një inventari mbi trashëgiminë arkeologjike dhe përcaktimin e monumenteve dhe zonave në mbrojtje;

ii) krijimin e rezervave arkeologjike, edhe ku nuk ka rrënoja të dukshme mbi tokë apo nën ujë, për ruajtjen e dëshmimeve materiale për t'u studiuar nga brezat e ardhshëm;

iii) raportimin e detyrueshëm tek autoritetet përkatëse nga ana e zbuluesit të një gjetje të rastësishme të elementeve të trashëgimisë arkeologjike dhe vënia e tyre në dispozicion për studim.

Neni 3

Për ruajtjen e trashëgimisë arkeologjike dhe garantimin e rëndësisë shkencore të punëve studimore arkeologjike, secila Palë angazhohet:

i) të zbatojë procedura për autorizimin dhe mbikëqyrjen e gjurmëve dhe veprimtarive të tjera arkeologjike në mënyrë të tillë që:

a) të parandalojë çdo gjurmë të paligjshme apo zhvendosje elementesh të trashëgimisë arkeologjike;

b) të sigurojë që gjurmët arkeologjike dhe kërkimet të kryhen në mënyrë shkencore dhe me kusht që:

- të zbatohen, aty ku është e mundur, metoda joshkatërruese investigimi;

- elementet e trashëgimisë arkeologjike të mos lihen të pambuluara apo të ekspozuara gjatë ose pas gjurmëve, nëse nuk merren masa për ruajtjen, konservimin apo menaxhimin e tyre të përshtatshëm.

ii) të sigurojë që gjurmët dhe teknikat e tjera potencialisht shkatërruese të kryhen vetëm nga persona të kualifikuar dhe posaçërisht të autorizuar;

iii) të vërë detyrimin e autorizimit specifik paraprak, nëse parashikohet nga ligji i brendshëm i shtetit, për përdorimin e gjurmuesve metalikë dhe të çdo pajisjeje tjetër gjurmuese apo procesi tjetër arkeologjik.

Neni 4

Secila Palë merr përsipër të zbatojë masa për mbrojtjen fizike të trashëgimisë arkeologjike, duke marrë masa në pajtim me rrethanat për:

- i) përfitimin ose mbrojtjen me mjete të tjera të përshtatshme nga ana e autoriteteve të zonave që mendohen të përbëjnë rezervate arkeologjike;
- ii) konservimin dhe ruajtjen e trashëgimisë arkeologjike, mundësisht *in situ*;
- iii) vende për depozitim të përshtatshëm të mbetjeve arkeologjike, të cilat janë zhvendosur nga vendndodhja e tyre origjinale.

Konservimi i integruar i trashëgimisë arkeologjike

Neni 5

Secila Palë angazhohet:

- i) të përpikët të përputhë dhe të kombinojë kërkesat përkatëse të planeve arkeologjike dhe të zhvillimit duke siguruar që arkeologët të marrin pjesë:
 - a) në politikat planifikuese të hartuara për të siguruar strategji të balancuara për mbrojtjen, konservimin dhe shtimin e vendeve me interes arkeologjik;
 - b) në faza të ndryshme të skemave të zhvillimit;
- ii) të sigurohet që arkeologët, planëzuesit urbanë dhe rajonalë të konsultohen në mënyrë sistematike me njëri-tjetrin për të lejuar:
 - a) modifikimin e planeve të zhvillimit në mënyrë që të mos kenë efekte negative mbi trashëgiminë arkeologjike;
 - b) caktimin e kohës dhe burimeve të mjaftueshme për një studim të saktë shkencor të vendit dhe për botimin e gjetjeve;
- iii) të sigurojnë që vlerësimet mbi ndikimet mjedisore dhe vendimet që rezultojnë të marrin tërësisht në konsideratë vendet arkeologjike dhe mjediset e tyre;
- iv) të sigurojnë, kur gjenden elemente të trashëgimisë arkeologjike gjatë punës zhvilluese, konservimin e tyre *in situ*, kur është e mundur;
- v) të sigurojnë që hapja e vendit arkeologjik për publikun, veçanërisht kur është e nevojshme një masë rregullimi për pranimin e një numri të madh vizitorësh, të mos ketë ndikim të kundërt mbi karakterin shkencor dhe arkeologjik të këtyre vendeve dhe rrethinave të tyre.

Financimi i kërkimeve dhe konservimit arkeologjik

Neni 6

Secila Palë mer përsipër:

- i) të sigurojë mbështetje financiare publike për kërkime arkeologjike nga autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale në pajtim me kompetencat e tyre përkatëse;
- ii) të rrisin burimet materiale për arkeologjinë e shpëtimit:
 - a) duke marrë masa të përshtatshme, që sigurojnë parashikimin në skemat madhore të zhvillimit, publik apo privat, të mbulimit nga burimet e sektorit publik apo sektorit privat, të të gjitha shpenzimeve të çdo operacioni të nevojshëm që lidhet me arkeologjinë;
 - b) duke parashikuar në buxhetet që lidhen me këto skema në të njëjtën mënyrë si për studimet e impaktit që bëhen të domosdoshme për masat paraprake për planet rajonale dhe mjedisore, për studimet dhe parashikimet paraprake arkeologjike, për një përmbledhje shkencore, si dhe për botimin e plotë dhe regjistrimin e gjetjeve.

Grumbullimi dhe shpërndarja e informacionit shkencor

Neni 7

Me qëllim që të lehtësohet studimi dhe shpërndarja e informacionit për zbulimet arkeologjike, secila Palë angazhohet:

- i) të bëjë ose të përditësojë studime, inventarë dhe harta të vendeve arkeologjike në zonat brenda juridiksionit të saj;

ii) të marrë të gjitha masat praktike për të siguruar projektimin, pas operacioneve arkeologjike, të një përmbledhjeje shkencore të botueshme para botimit të plotë të studimeve të specializuara.

Neni 8

Secila Palë merr përsipër:

i) të lehtësojë shkëmbimin kombëtarë dhe ndërkombëtarë të elementeve të trashëgimisë arkeologjike për qëllime shkencore profesionale, duke ndërmarrë hapat e duhura për të siguruar që një qarkullim i tillë të mos dëmtojë në asnjë mënyrë vlerën shkencore dhe kulturore të këtyre elementeve;

ii) të mbështesë grumbullimin e informacionit mbi studimin dhe gërmimet arkeologjike në kryerje e sipër dhe të kontribuojë në organizimin e programeve studimore ndërkombëtare.

Promovimi i ndërgjegjësimit publik

Neni 9

Secila Palë merr përsipër:

i) të zbatojë masa edukative me synim rritjen dhe zhvillimin e ndërgjegjësimit në opinionin publik mbi vlerat e trashëgimisë arkeologjike për kuptimin e të kaluarës dhe mbi kërcënimet që i kanosen kësaj trashëgimie;

ii) të nxisë hyrjen publike tek elementet e rëndësishme të trashëgimisë së saj arkeologjike, veçanërisht vendet dhe të nxisë ekspozimin në publik të përzgjedhjeve të përshtatshme të objekteve arkeologjike.

Parandalimi i qarkullimit të paligjshëm i elementeve të trashëgimisë arkeologjike

Neni 10

Secila Palë merr përsipër:

i) të organizojë për autoritetet publike përkatëse dhe për institucionet shkencore mbledhjen e informacionit mbi çdo gërmim të paligjshëm të identifikuar;

ii) të informojë autoritetet kompetente në shtetin e origjinës, që është Palë në këtë Konventë, për çdo ofertë të dyshuar që vjen nga gërmimet e paligjshme apo nga gërmimet zyrtare në mënyrë të paligjshme, dhe të japë detajet e nevojshme për to;

iii) të ndërmarrë hapat e nevojshëm që sigurojnë që muzetë dhe institucionet e ngjashme me to, politika e përfitimit për të cilat është nën kontrollin e shtetit, të mos përfitojnë elemente të trashëgimisë arkeologjike që dyshohet se vijnë nga gjetjet të pakontrolluara apo gërmime të paligjshme, apo nga gërmime zyrtare në mënyrë të paligjshme;

iv) përsa u përket muzeve apo institucioneve të ngjashme me to që ndodhen në territorin e një Pale, por që politika e përfitimit e të cilave nuk është në kontrollin e shtetit:

a) t'u dërgojë atyre tekstin e kësaj Konvente (të rishikuar);

b) të mos kursejnë përpjekjet për të siguruar respektimin nga ana e muzeve dhe institucioneve të sipërpërmendura të parimeve të përcaktuara në paragrafin 3 më sipër;

c) të kufizojnë, sa të jetë e mundur, nëpërmjet edukimit, informimit, vigjilencës dhe bashkëpunimit, transferimin e elementeve të trashëgimisë arkeologjike, të përfutur nga gjetjet e pakontrolluara apo gërmimet e paligjshme, apo gërmimet zyrtare në mënyrë të paligjshme.

Neni 11

Asgjë në këtë Konventë (të rishikuar) nuk mund të ndikojë në traktatet ekzistuese apo të ardhshme, dypalëshe ose shumëpalëshe, ndërmjet Palëve që kanë të bëjnë me qarkullimin e paligjshëm të elementeve të trashëgimisë arkeologjike apo rikthimin e tyre te pronari i ligjshëm.

Ndihma e ndërsjellë teknike dhe shkencore

Neni 12

Palët marrin përsipër:

i) të ofrojnë ndihmë të ndërsjellë teknike dhe shkencore nëpërmjet grumbullimit të përvojës dhe shkëmbimeve të ekspertëve në çështje që kanë të bëjnë me trashëgiminë arkeologjike;

ii) të inkurajojnë, sipas legjislacionit përkatës të brendshëm apo marrëveshjeve ndërkombëtare që i

detyrojnë ato, shkëmbime të specialistëve në ruajtjen e trashëgimisë arkeologjike, duke përfshirë ata që janë përgjegjës për trajnim të mëtejshëm.

Kontrolli i zbatimit të Konventës (të rishikuar)

Neni 13

Për qëllime të kësaj Konvente (të rishikuar), një komitet ekspertësh, i ngritur nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, bazuar në nenin 17 të Statutit të Këshillit të Europës, monitoron zbatimin e Konventës (të rishikuar) dhe veçanërisht:

i) raporton në mënyrë periodike te Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mbi gjendjen e politikave për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike në Shtetet Palë të Konventës (të rishikuar) dhe mbi zbatimin e parimeve të mishëruara në Konventë (të rishikuar);

ii) i propozon Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës masa për zbatimin e dispozitave të Konventës (të rishikuar), duke përfshirë veprimtaritë shumëpalëshe, rishikimin apo amendimin e Konventës (të rishikuar) dhe informimin e opinionit publik rreth qëllimit të Konventës (të rishikuar);

iii) i bën rekomandime Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës në lidhje me ftesat për shtetet, të cilat nuk janë anëtare të Këshillit të Europës për të hyrë në Konventë (të rishikuar).

Dispozita të fundit

Neni 14

1. Kjo Konventë (e rishikuar) është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe Shtetet e tjera Palë në Konventën Kulturore Europiane.

Ajo i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Mjetet e ratifikimit, pranimit apo miratimit depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

2. Asnjë Shtet Palë në Konventën Europiane mbi Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike, nënshkruar në Londër, më 6 maj 1969, nuk mund të depozitojë mjetin e tij të ratifikimit, pranimit apo miratimit, nëse ai nuk e ka denoncuar Konventën në fjalë apo nëse nuk e denoncon atë njëkohësisht.

3. Kjo Konventë (e rishikuar) hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës kur katër shtete, ku të paktën tri janë shtete anëtare të Këshillit të Europës, kanë shprehur vullnetin e tyre për t'iu nënshtruar kësaj Konvente në përputhje me dispozitat e paragrafëve pararendës.

4. Nëse në pajtim me dy paragrafët pararendës, denoncimi i Konventës së 6 majit 1969 nuk hyn në fuqi njëkohësisht me hyrjen në fuqi të kësaj Konvente (të rishikuar) një shtet nënshkrues, kur depoziton instrumentin e ratifikimit, pranimit apo miratimit, mund të deklarojë që ai do të vazhdojë të zbatojë Konventën e 6 majit 1969 deri në hyrjen në fuqi të kësaj Konvente (të rishikuar).

5. Në lidhje me çdo shtet nënshkrues, i cili e shpreh më vonë vullnetin e tij për t'iu nënshtruar kësaj Konvente, Konventa (e rishikuar) hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit apo miratimit.

Neni 15

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente (të rishikuar), Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të ftojë çdo shtet tjetër joanëtar të Këshillit të Europës dhe të Komunitetit Ekonomik European, të aderojë në këtë Konventë (të rishikuar) me vendim të marrë nga shumica e parashikuar në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Europës dhe nga vota unanime e përfaqësuesve të shteteve kontraktuese që kanë të drejtën të jenë në Komitetin e Ministrave.

2. Në lidhje me çdo shtet aderues ose nëse aderon, në Komunitetin Ekonomik, Konventa (e rishikuar) hyn në fuqi 6 muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 16

1. Çdo shtet në kohën e nënshkrimit apo kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit mund të specifikojë territorin, apo territoret në të cilat kjo Konventë (e rishikuar) zbatohet.

2. Çdo shtet edhe në një datë të mëvonshme, nëpërmjet një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund ta shtrijë zbatimin e kësaj Konvente mbi çdo territor tjetër të

përcaktuar në deklaratë. Në lidhje me një territor të tillë, Konventa hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes së kësaj deklarate nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve pararendës, në lidhje me territorin e specifikuar në këtë deklaratë, mund të tërhiqet me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 17

1. Secila Palë mund ta denoncojë këtë Konventë (të rishikuar) në çdo kohë nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Ky denoncim hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 18

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit të Europës, Shtetet e tjera Palë në Konventën Europiane Kulturore dhe çdo shtet apo Komunitetin Ekonomik Europian që kanë aderuar ose janë ftuar të aderojnë në këtë Konventë për:

i) çdo nënshkrim;

ii) depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi apo aderimi;

iii) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente (të rishikuar) në përputhje me nenet 14, 15 dhe 16;

iv) çdo akt tjetër, njoftim apo komunikim që lidhet me këtë Konventë (të rishikuar).

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit të autorizuar rregullisht kanë nënshkruar këtë Konventë (të rishikuar).

Bërë në Valetta, më 16 janar 1992 në gjuhët angleze dhe franceze, ku të dy tekstet janë të barasvlefshëm, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës u përcjell kopje të vërtetuara çdo shteti anëtar të Këshillit të Europës, çdo Shteti tjetër Palë në Konventën Kulturore Europiane, dhe çdo shteti joanëtar apo komunitet ekonomik europian, të ftuar për të aderuar në këtë Konventë (të rishikuar).

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME**

BOTIME TË REJA *(Të përditësuara gusht 2007)*

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat
- Kodi i familjes (përfshirë legjislacioni për birësimet)

Hyri në shtyp më 1.10.2007
Doli nga shtypi më 3.10.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 12 lekë